



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 65 prot.

Kamëz, më 25.8.2025

V E N D I M
Nr. 56 .Datë 27.8 2025
M B I

“VIJIMIN E TRAJTIMIT ME BONUS QIRAJE PËR FAMILJET E PREKURA NGA PROJEKTI “UNAZA E MADHE E TIRANËS –BULEVARDI I RI – SHKOZË” NJËSIA ADMINISTRATIVE PASKUQAN DHE JU PËRFUNDON MARRËVESHJA TIP E TRAJTIMIT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 25.08.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.52 Datë 19.08.2025 në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 59 ; ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative së Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”; Ligjit nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.409, datë 15.06.2022 “Për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve pa leje që nuk legalizohen”; Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Kamëz me nr.530, prot, datë 30.07.2025 “Për ngritjen e grupit punës për vijimin e trajtimit me bonus qiraje për familjet e prekura nga projekti “Unaza e Madhe e Tiranës – Bulevardi i Ri – Shkozë” Njësia Administrative Paskuqan dhe ju përfundon Marrëveshja Tip e Trajtimit”; VKB nr.99, datë 27.07.2022 “Mbi miratimin e manualit të procedurave për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që preken nga realizimi i projektit “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri, Shkozë, Njësia Administrative Paskuqan”; dhe V.K.B Kamez Nr. 119, datë 19.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2025 dhe planit të buxhetit për vitet 2026 dhe 2027, Relacionit të grupit të punës me nr. Prot 7140 datë 19.08.2025 **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e vijimit të trajtimit me bonus qiraje për familjet e prekura nga projekti, “Unaza e Madhe e Tiranës – Bulevardi i Ri – Shkozë” Njësia Administrative Paskuqan dhe ju përfundon Marrëveshja Tip e Trajtimit.
2. Lista e familjeve sipas pikës 1 paraqitet në aneksin bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Pagesa do të bëhet sipas strukturës buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 10661, Art. 606,
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Emergjencave Civile dhe Strehimit, Grupi Punës, si dhe Drejtoria Financës dhe Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASH